



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1203 prot.

Tiranë, më 30. 12. 2016

Lënda: Dërgohet Rekomandimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi pas shqyrtimit të çështjes së zhvendosjes tranzitore të familjeve të komunitetit rom të cilët banonin në zonën e Bregut të Lumit, Tiranë.

Drejtuar: **Z. Erion Veliaj**
Kryetar
Bashkia Tiranë

Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë

I nderuar Z. Veliaj,

Mbështetur në nenin 32, gërma a) dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në Urdhërin nr. 198, datë 06.12.2016, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen e zhvendosjes nga ana e Bashkisë Tiranë të familjeve të komunitetit rom të cilët banonin në zonën e Bregut të Lumit, Tiranë, pranë godinës së ish-Uzinës së Traktorëve.

Referuar informacionit¹ të Bashkisë Tiranë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është vënë në dijeni se: *“...janë vlerësuar nevojat social-ekonomike të 74 familjeve, nga të cilat 11 janë mbështetur me bonus qiraje, 3 janë akoma në proces dhe 60 familje do të zhvendosen në ish-repartin ushtarak nr. 8837, Shkozë...Për shkak të përmbytjeve dhe rrezikshmërisë së lartë që paraqet dalja e lumit nga shtrati, Bashkia e Tiranës po merr të gjitha masat e nevojshme për krijimin e kushteve më të përshtatshme për 60 familje të komunitetit rom, që aktualisht banojnë në zonën e Bregut të Lumit...Në datën 23 Nëntor 2016, stafi i Bashkisë, bazuar në Planin e Ndërhyrjes, ka zhvilluar takime individuale me familjet, për qartësimin e zhvendosjes tranzitore në godinën e ish-Uzinës së Traktorëve (UNPNA), me vendodhje në zonën e Shkozës, e cila po përshtatet me kushtet minimale të jetesës...Gjatë qëndrimit në këtë godinë, familjet do të mbështeten nga stafi i Bashkisë Tiranë dhe nga Qendrat Sociale deri në përfundimin e rikonstruksionit dhe ndërtimit të 60 njësive të banimit në ish-repartin ushtarak në zonën e Shkozës për këto familje.”*

¹ Mbështetur në shkresën Nr. 36679 prot., datë 01.12.2016 të Bashkisë Tiranë.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

Lidhur me zhvendosjen e familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian nga zona e Bregut të Lumit Tiranë, për shkak të rehabilitimit të kësaj zone, komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori dijeni edhe nga aktivisti për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit rom dhe egjiptian, z. Ervis Daka.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndoqi procedurat përkatëse për trajtimin e çështjes së sipërpërmendur:

1. Më datë 05.12.2016, përfaqësues të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për marrjen e një informacioni më të detajuar përreth kësaj situatë u paraqitën pranë ambjenteve të ish-Uzinës së Traktorëve Tiranë, ku ishin vendosur familjet e transferuara nga zona e Bregut të Lumit, ku morën takim me këta të fundit për t’u informuar mbi kushtet dhe situatën në të cilën ndodhen këto familje. Ndër të tjera, përfaqësuesit e KMD-së u informuan dhe konstatuan se:

Nga zona e Bregut të Lumit Tiranë ishin zhvendosur rreth 60 familje. Sipas informacionit të përcjellë nga këto familje, përfaqësues të Bashkisë Tiranë gjatë muajit nëntor 2016, kanë mbajtur disa takime me komunitetin e kësaj zone. Me pjesën më të madhe të tyre është rënë dakord që të zhvendosen pranë ambjenteve të ish-Uzinës së Traktorëve Tiranë, ndërsa një pjesë prej tyre nuk kanë qënë të gatshëm të zhvendosen. Megjithatë, të ndodhur përpara faktit që strehimi në ambjentet e ish-Uzinës së Traktorëve Tiranë, do të jetë për një periudhë 6 mujore, ka bërë që edhe këto familje të zhvendosen.

Gjatë takimit me familjet e zhvendosura në ambjentet e ish-uzinës së Traktorëve, u konstatua se:

- Familjet ishin të vendosura në një godinë 2 (dy) katëshe, e cila ka qënë një prej magazinave të ish-Uzinës së Traktorëve. Në katin e parë të ndërtesës ishin të vendosura 11 çadra, ndërsa në katin e dytë të saj ishin të vendosura 19 çadra. Çadrat e siguruara nga Bashkia Tiranë ishin vendosur në një platformë druri dhe në çdo hapsirë ndërmjet dy çadrave ishte vendosur nga një sobë me dru për ngrohje. Fillimisht lënda drusore ishte siguruar nga ana e Bashkisë Tiranë, por në vijim familjet nuk kishin informacion nëse do duhet t’i siguronin individualisht ato.
- Lidhur me arsimimin e fëmijëve, familjet e zhvendosura sqaruan se, nga ana e Bashkisë Tiranë po ndërmerreshin masa që fëmijët të rregjistroheshin të gjithë në shkollat pranë zonës së Shkozës. Aktualisht, sipas tyre po ndiqeshin procedurat e regjistrimit në shkollat respektive.
- Lidhur me kushtet higjieno-sanitare, Bashkia Tiranë kishte vënë në dispozicion të banorëve 5 (pesë) kabina tualeti të lëvizshme dhe 2 (dy) depozita uji. U konstatua se



Adresa: Rruga Sami Frasherit, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

furnizimi me ujë të pijshëm ishte problem për këto familje, pasi edhe pse ishin vendosur depozitat e ujit, ato kishin rreth 24 orë që nuk furnizoheshin.

- Një pjesë e vogël e familjeve të komunitetit rom dhe egjiptian ishin vendosur në ambjentet e Banesave Sociale të ndërtuara nga Bashkia Tiranë në zonën e Shkozës, ndërsa pjesa më e madhe e familjeve ishin strehuar në ambjentet e ish-Uzinës së Traktorëve.

Në përfundim të takimit, familjet e zhvendosura bënë me dije se, nuk janë pajisur të gjitha familjet e zhvendosura me çadra nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi ka raste që në një nga çadrat të jetojnë mbi 5 (pesë) persona.

Sa më sipër:

- Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 18 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, nenin 14 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe në Raportin² e Vitit 2016 për Shqipërinë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese, sidomos për sa i përket strehimit të komunitetit ROM, në Shqipëri.
- Mbështetur në nenin 32, gërma f), të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, ku parashikohet shprehimisht ***kompetenca e Komisionerit për të kryer rekomandime për çfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin***, si dhe duke patur si qëllim në vetëvete mirëbesimin dhe krijimin e marrëdhënieve sa më normale, të mbështetura në parimin e barazisë dhe aspak diskriminuese, ndërmjet Komunitetit Rom dhe institucioneve shtetërore,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi :

REKOMANDON :

1. Marrjen e masave nga ana e Bashkisë Tiranë, për pajisjen me çadra të të gjitha familjeve të shpërngulura në ambjentet e ish-Uzinës së Traktorëve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Tiranë, për ndërmjetësimin me institucionet përkatëse dhe rregjistrimin e fëmijëve në shkollat e zonës së ish-Uzinës së Traktorëve.
3. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Bashkisë Tiranë, për sigurimin e lëndës së parë drusore për ngrohje, për të gjitha familjet e zhvendosura në ish-Uzinën e Traktorëve Tiranë.

² Pika 2.4 “Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve”

4. Marrjen e masave të menjëhershme për furnizimin 24 orë, me ujë të pijshëm të familjeve të zhvendosura në ish-Uzinën e Traktorëve Tiranë.

Për sa më sipër, shpresojmë dhe besojmë në një bashkëpunim sa më të frytshëm ndërmjet institucioneve tona në të ardhmen, duke e vlerësuar maksimalisht mirëkuptimin Tuaj, në mënyrë që institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kryejë detyrat e tij funksionale, në mënyrë sa më korrekte dhe konform ligjeve dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj,

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Konceptoi: R. Babaj

Pranoi: V. Bushati

Date: 24.10.2016



Adresa: Rruga Sami Frasherit, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al